**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
**“HASAN PRISHTINA”**
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit,10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel:+381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · ëëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** AGROEKONOMI

**Programi:** EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

# NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati LAURETA DUGA, me titull: ***"Institucionet Mikrofinanciare në Kosovë - Gjendja dhe Perspektiva e tyre***‘’ ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 16.12.2024 deri me datë 23.12.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben MUSLIU kryetar,
2. Prof. Asco. Dr. Jehona SHKODRA, mentor - anëtare,
3. Prof. Ass. Dr. Iliriana MIFTARI, anëtare

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkoni te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra, përmes e-mail adresës jehona.shkodra@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
**"HASAN PRISHTINA"**
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Departamenti: AGROEKONOMI

Drejtimi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit

# PUNIM DIPLOME

(Studime Master)

"Institucionet Mikrofinanciare në Kosovë - Gjendja dhe Perspektiva e tyre"

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra

Kandidate: B.Sc. Laureta Duga

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Institucionet mikrofinanciare në Kosovë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për individët dhe ndërmarrjet e vogla. Ky sektor ka pasur një rritje të shpejtë që nga paslufta, duke ofruar kredi për ata që nuk mund të qasen në bankat komerciale tradicionale. Këto institucione kanë mundësuar rritjen e ndërmarrësisë, veçanërisht në zona rurale dhe për grupet që janë përjashtuar nga sistemet tradicionale financiare.

Në këtë studim shqyrtohet gjendja aktuale e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë, duke përfshirë faktorët që ndikojnë në operimet e tyre, sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e shërbimeve. Analiza tregon se, megjithatë, këto institucione kanë pasur sukses në ofrimin e shërbimeve financiare për grupet më të margjinalizuara, ato përballen me sfida si pasiguria e ligjore, konkurrenca e ngushtë dhe mungesa e kapitalit të mjaftueshëm për të mbështetur kërkesat e klientëve.

Në perspektivën e ardhshme, ka mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori përmes forcimit të kornizës ligjore dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve mikrofinanciare, bankave dhe qeverisë. Një zhvillim i qëndrueshëm mund të arrihet përmes inovacioneve në shërbimet financiare, ofrimit të produkteve të reja dhe përmirësimit të aftësive menaxheriale të këtyre institucioneve. Në këtë kontekst, roli i institucioneve mikrofinanciare mund të jetë kyç në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe integrimin social të grupeve më të brendshme të shoqërisë kosovare.

Qëllimi i këtij punimi kërkimor është zhvillimi i analizës së sektorit të mikrokredisë në Kosovë, identifikimi dhe analiza e përbërësve që ndikojnë në përcaktimin e normave të interesit për mikrokreditë në vendin tonë. Për më tepër, hulumtimi do të vlerësojë nëse IMF-të dhe normat e interesit janë në përputhje me planet e tyre të biznesit, si dhe do të bëhet krahasimi i normave të interesit të Kosovës me vendet ballkanike.

***Fjalët kyçe:*** Mikrofinancë, Institucione Mikro-finaciare, Sistemi mikrofinaciar, Zhvillimin ekonomik lokale.

ABSTRACT

Microfinance institutions (MFIs) in Kosovo have played a crucial role in promoting economic development and improving the living conditions of individuals and small enterprises. This sector has experienced rapid growth since the post-war period, providing credit to those who do not have access to traditional commercial banks. These institutions have facilitated the growth of entrepreneurship, particularly in rural areas and for groups excluded from traditional financial systems.

This study examines the current status of microfinance institutions in Kosovo, including the factors that influence their operations, the challenges they face, and the opportunities to improve their services. The analysis shows that despite their success in providing financial services to marginalised groups, these institutions face challenges such as legal uncertainties, strong competition and a lack of sufficient capital to meet client demand.

Looking to the future, there is potential for further development of this sector by strengthening the legal framework and increasing co-operation between microfinance institutions, banks and the government. Sustainable development can be achieved through innovation in financial services, the introduction of new products and the improvement of the management capacities of these institutions. In this context, the role of microfinance institutions can be crucial in promoting economic development and social inclusion of the more marginalised groups in Kosovar society.

The aim of this research is to develop the analysis of the microcredit sector in Kosovo, to identify and analyse the components that influence the determination of interest rates for microcredit in our country. In addition, to analyse whether the MFIs and interest rates are in line with their business plans. In addition, the interest rates in Kosovo will be compared with those of the Balkan countries.

***Key words:*** Microfinance, Micro-financial institutions, Microfinance system, Local economic development.